

VENDIM
Nr. 752, datë 5.9.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “BULEVARDI VERIOR DHE REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS”, FAZA I, NË BASHKINË E TIRANËS
(Ndryshuar me VKM nr. 153, datë 2.3.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve dhe poseduesve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës”, faza I, në favor të Bashkisë së Tiranës.

2. Pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelat bashkëlidhur dhe që janë pjesë përbërëse të këtij vendimi, për sipërfaqen 38 642 (tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) m², truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 912 622 642 (nëntëqind e dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) lekësh, dhe për 204 objekte me vlerë 844 853 879 (tetëqind e dyzet e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh.

3. *Vlera e plotë e shpronësimit, prej 1 757 476 521 (një miliard e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e një) lekësh, do të përballohet në masën 550 000 000 (pesëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë dhe, pjesa e mbetur, nga Bashkia e Tiranës.*

4. Për objektet informale, pagesat për shpronësim nga Bashkia e Tiranës përfundojnë kur poseduesi i objektit/shtesës pa leje i nënshkruan Bashkisë së Tiranës deklaratën, sipas aneksit A të këtij vendimi.

5. Për pasuritë që sipas konfirmimit nga ZVRPP-ja Tiranë, janë në proces të regjistrimit fillestar, procedurat e shpronësimit do të ndiqen pas përfundimit të këtij procesi.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Bashkia Tiranë, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë së Tiranës.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

8. Ngarkohet Ministria e Brendshme për njoftimin e këtij vendimi subjekteve, prona e të cilëve preket nga shpronësimi, dhe personave të tretë, të drejtat e të cilëve kompensohen për shkak të këtij shpronësimi, të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente vetëm lidhur me masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Bashkia e Tiranës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha